



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.253/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës në Prishtinë, kundër debitorit Ndërmarrja Agonisi me numër biznesi 8024734 fshati Carrabreg Komuna e Deçanit, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, e parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, EP.5/2018 i datës 10.07.2023, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kreditorit Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, EP.5/2018 i datës 10.07.2023, dhe Lënda kthehet te Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, në rivendosje

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Themelore në Pejë, Dega në Deçan me aktvendimin e ankimuar EP.5/2018 i datës 10.07.2023, ka vendosur si ne vijim: I. Aprovohet prapësimi i ushtruar nga debitori Ndërmarrja Agonisi me numër biznesi 8024734 fshati Carrabreg Komuna e Deçanit, ndaj kreditorit Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhërit të përmbaruesit Ep.nr.05/2018 datës 07.02.2018, dhe ka Anuluar urdhrin përmbarimor Ep.nr.05/2018 datës 07.02.2018

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e kreditorit Avokatura Shtetërore, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, dhe ta anuloj ne tërësi aktvendimin Ep.nr.05/2018 datës 10.07.2023.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigje në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës në Prishtinë, me datën 18.01.2017, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Ndërmarrja Agonisi me numër biznesi 8024734 fshati Carrabreg Komuna e Deçanit, dhe M.L. nga fshati Carrabreg Komuna e Deçanit, bazë të dokumentit të besueshëm-faturave B-72/2015 date 12.12.2015 dhe B-72/2014 datë 12.11.2014 në vlerë kumulative prej 2,100.00€.

Përmbartuesi privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor Ep.nr.05/2018 datës 07.02.2018, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën e cekur si me larte.

Kundër këtij urdhri i autorizuari i debitorit ka paraqitur prapësim, duke kundërshtuar faturat e bashkangjitura në kuptim të lartësisë së faturuar dhe lartësisë së metrit katror të shfrytëzuar, Gjithashtu në prapësim debitori konteston borxhin e vitit 2014 për shkak të parashkrimit, i propozon gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor dhe të detyrohet kreditori t,ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori i cili ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar në kuptim të nenit 73 par.1 pika 1.3 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan, në rivendosje, duke vepruar sipas aktvendimit Ac.nr.2867/2020 dt.28.04.2021 të Gjykatës së Apelit, pas vlerësimit shkresave të lëndës dhe faturave, sugjerimet e Apelit, ka marr Aktvendimin ankimor EP.5/2018 datës 10.07.2023 me të cilin ka Aprovuar prapësimin e ushtruar nga debitori Ndërmarrja Agonisi me numër biznesi 8024734 fshati Carrabreg Komuna e Deçanit, ndaj kreditorit Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhërit të përmbartuesit Ep.nr.05/2018 datës 07.02.2018, dhe ka Anuluar urdhrin përmbartimor Ep.nr.05/2018 datës 07.02.2018

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e konsideron të papërshtatshëm për përmbartim dokumentin e besueshëm faturat B-72/2015 date 12.12.2015 dhe B-72/2014 datë 12.11.2014, në bazë të nenit 27 dhe nenit 29 ppar.3 të LPP-së. Gjykata vlerësoi se të dy faturat janë të nënshkuara nga kreditori dhe debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të nenit 182 par.2 pika (f) dhe (n) të LPK-së, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, ne bazë të detyrës zyrtare, vlerësoi se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par.2 pika (f) të LPK-së, sepse në këtë rast kompetent në gjykimin e kësaj çështje përmbartimore është Gjykata Komerciale e Kosovës, e cila gjykatë ka filluar punën, pas miratimit të Ligjit 08/L-015 datë 22.01.2022.

Dispozita e nenit 13 dhe 28 të Ligjit 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, parasheh:

1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;

28. Të gjitha veprimet në procedurat përmbartimore do të trajtohen me prioritet dhe në përputhje me afatet e parashikuara në Ligjin në fuqi për Procedurën Përmbartimore.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit, nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare respektivisht ka dhënë deklarata kontradiktore sa i përket faktit se debitori ka pranuar si të rregullt faturat përmbartimore. Kjo gjykatë nga shkresat e lëndës, vlerësoi se Propozimit për përmbartim, i iniciuar nga kreditori, i janë bashkangjitur të dy faturat B-72/2015 date 12.12.2015 dhe B-72/2014 datë 12.11.2014, të cilat fatura janë të vulosura dhe nënshkuara nga kreditori, pastaj vërehet në pjesën e poshtme të faturës, se te rubrika nënshkrimi i palës nuk ka asnjë nënshkrim ndërsa te rubrika faturoi, ekziston një nënshkrim pa u identifikuar se i cilës palë ndërgjyqëse është. Kjo gjykatë gjithashtu vlerësoi se nga prapësimi i debitorit i datës 16.02.2018 i parashtruar kundër urdhrin përmbartimor, nuk kundërshtohet rregullsia e këtyre dy faturave, por si fakt vendimtar është kontestuar çështja e parashkrimit të borxhit nga viti 2014.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast, meqë nuk mund të shqyrtohet vërtetësia dhe ligjshmëria e dokumenteve të besueshme faturave përmbartimore, bashkangjitura propozimit për përmbartim, dhe ekzistojnë kontradikta të dukshme në vlerësimin e gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, duke mos vlerësuar pretendimet me rendësi që mund të kenë ndikim në këtë rast, tani për tani kjo gjykatë nuk ka mund të pranoj si të rregullt aktvendimin e atakuar.

Në ri procedurë, Dhomat e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, duhet të veprojnë në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojnë edhe njëherë pretendimet e palëve ndërgjyqëse, respektivisht të vlerësojnë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbartimit nga ana e përmbartuesit privat, të shqyrtohen pretendimet e dy palëve ndërgjyqëse në drejtim të përmbartjes së detyrimeve që rrjedhin nga dokumenti i besueshëm faturat, dhe pretendimet në rast se ka arrit afati i parashkrimit që parashihet me dispozitat e LMD-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.253/2024 me datë 25.03.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha